

LIGJ
Nr.7374, datë 8.5.1990

PËR ÇMIMET DHE TARIFAT

Me qëllim që të ngrihet në një nivel më të lartë puna e organeve shtetërore dhe të ekonomisë në fushën e çmimeve e të tarifave,

Me propozimin e Këshillit të Ministrave, në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës,

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS
POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë çmimet dhe tarifat caktohen në bazë të kërkesave të ligjeve ekonomike të socializmit. Në caktimin e tyre mbahet parasysh vlera e produkteve dhe e mallrave, si dhe faktorët ekonomikë, politikë dhe shoqërorë që lidhen me përsosjen e marrëdhënieve socialiste në prodhim, me forcimin e lidhjeve ekonomike ndërmjet qytetit e fshatit, akumulimin socialist dhe sigurimin e ngritjes së mirëqenies së popullit.

Neni 2

Çmimet e shitjes me shumicë dhe çmimet e shitjes me pakicë të mallrave të prodhuara në vend ose të importuara, çmimet e blerjes nga shteti të produkteve bujqësore e blegtorale të kooperativave bujqësore, çmimet e preventivimit dhe tarifat e shërbimeve në përgjigjëse caktohen nga shteti në mënyrë të centralizuar e të planifikuar dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga organet shtetërore, ndërmarrjet, institucionet dhe kooperativat bujqësore.

Shitja e produkteve bujqësore e blegorale dhe kreyrja e riparim-shërbimeve komunale për anëtarët nga kooperativat bujqësore bëhen me çmime e tarifa të miratuara prej tyre, sipas kriteve të rekomanduara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 3

Sistemi i çmimeve përfshin:

- a) Çmimet e shitjes me shumicë të produkteve të ndërmarrjeve.
- b) Çmimet e blerjes nga shteti të produkteve bujqësore e blegtorale të kooperativave bujqësore.
- c) Çmimet e preventivimit.
- ç) Tarifat e shërbimeve në degë e sektorë të ndryshëm të ekonomisë e të kulturës.
- d) Çmimet e shitjes me pakicë të mallrave të përdorimit të gjerë.

Neni 4

Në formimin e çmimeve të shitjes me shumicë të produkteve të ndërmarrjeve mbahen parasysh këto kriterë:

- Nxitja e zhvillimit të prodhimit në sasi, llojshmëri e cilësi, kursimi i lëndëve të para dhe i materialeve kryesore, lëndëve djegëse e energjisë elektrike, ulja e shpenzimeve të prodhimit dhe rritja e akumulimit socialist.

- Kostoja e plotë mesatare ose e përparuar e degës për produktet industriale, kostoja e plotë mestare e vendburimeve të varfra në industrinë nxjerrëse, kostoja mesatare e prodhimit të tokave me pjellori të ulët sipas zonave në ndërmarrjet bujqësore, kostoja mesatare e mallrave ose e grup-mallrave për tarifat e transportit.

- Sigurimi i një rentabiliteti optimal, me synim që ndërmarrja të krijojë të ardhurën neto të saj,

të nevojshme për të kryer financimin e riprodhimit të zgjeruar me mjetet e veta, si dhe fondet për të stimuluar materialisht punonjësit. Shteti të japë donacion vetëm për raste të veçanta dhe të pranuar prej tij.

- E ardhura neto e centralizuar e shtetit të realizohet aty ku krijohet, jo vetëm për sendet e konsumit, por edhe për mjetet e prodhimit.

- Çmimet e shitjes me shumicë të produkteve e të mallrave diferencohen sipas llojit, asortimentit, numrit, përmasave dhe cilësisë.

Neni 5

Rishikimi i çmimeve me shumicë të bëhet edhe më shpejt se një herë në pesë vjet, për të pasqyruar efektet e ndjeshme në ndryshimin e shpenzimeve, si rrjedhin i faktorëve objektivë (progresit teknik, kushteve të sigurimit të lëndëve të para e atyre energjetike, koniunkturës së tregtisë së jashtme etj.).

Neni 6

Çmimet e shitjes me shumicë për mallrat e importit, ku ato prodhohen edhe në vend, njësohen me ato të vendit. Për disa lëndë të para e materiale, të cilat duhen përdorur me kursim, çmimet e shitjes me shumicë mund të caktohen më të larta të atyre që prodhohen në vend. Çmimet e shitjes me shumicë të makinerive e të pajisjeve të importit të ngjashme me ato të vendit, caktohen më të larta.

Neni 7

Në caktimin e çmimeve të blerjes nga shteti të produkteve bujqësore e blegtorale të kooperativave bujqësore mbahen parasysht këto kritere:

- Nxitja e prodhimit bujqësor e blegtoral për treg, duke siguruar leverdinë ekonomike për llojin, cilësinë dhe hershmërinë e prodhimit, krijimin e së ardhurës neto për riprodhimin e zgjeruar në kooperativat bujqësore dhe akumulimin për shtetin. Çmimet diferencohen për zonat fushore, kodrinore, malore, verilindore, si dhe për kooperativa të veçanta që janë në kushte të përafërta me këtë zonë.

- Sigurimi i shpërndarjes dhe i rishpërndarjes së të ardhurave kombëtare ndërmjet shtetit dhe kooperativave bujqësore.

- Kostoja mestare e produkteve bujqësore e blegtorale në tokat me pjellori të ulët, sipas zonave.

Neni 8

Çmimet e blerjes së produkteve bujqësore blegtorale të kenë karakter stimulues për tejkalimin e planit të dorëzimeve në shtet. Masa e stimulimit, në varësi nga interesat e ekonomisë për produkte të ndryshme, caktohet nga Këshilli i Ministrave, me kusht që shteti të mos përballojë humbje.

Neni 9

Në caktimin e çmimeve të shitjes me pakicë mbahen parasysht këto kritere:

- Nxitja e shtimit të prodhimit industrial e bujqësor në sasi, llojshmëri e cilësi, për të plotësuar kërkesë të popullit me mallra të përdorimit të gjerë.

- Ruajtja e qëndrueshmërisë së çmimeve dhe e nivelit të përgjithshëm të tyre. Për prodhimet e nevojës së parë çmimet të jenë të qëndrueshme dhe relativisht të ulëta, kurse për mallrat e tjera, jo të nevojës së parë dhe për raste të caktuara, çmimet edhe mund të lëvizin, për ta bërë faktorin ofertë-kërkesë nxitje për shtimin e prodhimit të rendimentit të punës dhe plotësimin më mirë të nevojave të punonjësve.

- Sigurimi i ngritjes së vazhdueshme të mirëqenies së masave punonjëse të qytetit e të fshatit, plotësimi i nevojave ekonomike, kulturore e shoqërore të karakterit masiv dhe ngushtimi i dallimeve në nivelin e të ardhurave dhe të jetesës ndërmjet fshatit e qytetit.

- Sigurimi i akumulimit të nevojshëm socialist për vazhdimin e riprodhimit të zgjeruar, zhvillimin e mëtejshëm të sektorëve social-kulturorë dhe forcimin e aftësisë mbrojtëse të Atdheut tonë socialist.

Neni 10

Ndryshimi i çmimeve të shitjes me pakicë për mallrat kryesore e të nevojës së parë, të tarifave të shërbimeve, të çmimeve të blerjes nga shteti të produkteve bujqësore e blegtorale nga kooperativat bujqësore, të tarifave të punimeve të stacioneve të makinave e traktorëve dhe të ujitjes bëhet nga Këshilli i Ministrave dhe organet që caktohen prej tij.

Neni 11

Organet shtetërore dhe ekonomike që kanë të drejtë të caktojnë çmime janë:

- a) Këshilli i Ministrave.
- b) Ministri, Komisioni i Planit të Shtetit dhe institucionet e tjera qendrore.
- c) Byroja e çmimeve në komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve.
- d) Drejtorët e ndërmarrjeve dhe kryesitë e kooperativave bujqësore.

Kompetencat e organeve shtetërore e të ekonomisë dhe kriteret për formimin e çmimeve e të tarifave prej tyre miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 12

Prodhimi, ndërtimi, shërbimi dhe shitja e produkteve dhe e mallrave pa çmime e tarifa të miratuara, moszbatimi i çmimeve dhe i tarifave për prodhimin, ndërtimin, shërbimin e shitjen, fryrja e prventivave për të realizuar të ardhura më të larta e të pamërituara, si dhe zbatimi i tyre jo në përputhje me sasinë e cilësinë e prodhimit, ndërtimit e të shërbimit, kur këto shkelje nuk formojnë vepër penale, dënohen si kundërvajtje administrative me qortim shoqëror ose me gjobpë deri në 500 lejë nga inspektorët e çmimeve të ministrive, të Komisionit të Planit të Shtetit, të institucioneve të tjera qendrore, të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, të ndërmarrjeve e të kooperativave bujqësore.

Neni 13

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, përkatësisht, te ministri, kryetari i Komisionit të Planit të Shtetit, titullari i institucionit tjetër qendror, kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, drejtori i ndërmarrjes dhe te kryetari i kooperativës bujqësore.

Neni 14

Organet që vendosin çmimet, kur gjatë veprimtarisë së tyre vërejnë shkelje që përbëjnë vepër penale, bëjnë kallzim në organet e hetuesisë.

Neni 15

Në dekretin nr.7095, datë 17.1.1987 "Për çmimet, standardet dhe kontrollin e cilësisë", kreu I shfuqizohet, kurse dispozitat e tjera të tij nuk zbatohen për çmimet e tarifat.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare.

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
SIHAT TOZAJ

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA